Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 01 Nr. Br. 22225
Nr. i faq. Br. str. 1 Data: Datum: 14/08 2025
KAMENICË/A

**Kuvendi Komunal**
**Datë: 14.05.2025**

Mbështetur në nenin 52 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 11 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.05/2020 Për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve të Tjera në Komunë, për mbajtjen e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi i Kuvendit me datë: 14.05.2025 :

**T H Ë R R E T**

Mbledhjen e -VIII-të të Komitetit për Politikë dhe Financa e cila do të mbahet ditën e **Enjte** me datë: **21.08.2025**, duke filluar nga ora **10:00.**

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës.
Për mbledhje propozoj këtë,

**R E N D   D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit, nga mbledhja e 7-të e Komitetit për Politikë dhe Financa.

2. Kërkesë për rishqyrtimin dhe harmonizimin e vendimit sipas rekomandimeve të MAPL-së me nr.Sh.01.Nr. 17378.

3. Të ndryshme.

**Liridon KASTRATI**

**Kryesues i Kuvendit të Kamenicës**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOS.
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Nr. U. 01 Nr. Br. 22226
Nr. i faq. Br. str. 2 Data: Datum: 14/08
KAMENICË/A 2025.

**P R O C E S V E R B A L**

**Nga mbledhja e VII-të e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më: 18.07.2025**

Mbledhja ishte e paraparë të mbahej më datë: 17.07.2025, por është shtyrë më datë: 18.07.2025 dhe filloj në ora 14:10. Në mbledhje përveç anëtarëve të pranishëm ishin edhe Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, shërbimi profesional i kuvendit, përkthyesi, zyra e informimit dhe përfaqësues të OSBE-së. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa Liridon Kastrati i cili për mbledhje propozoi këtë:

**Rend dite**

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e VI-të e Komitetit për Politikë dhe Financa,**
2. **Kërkesë për rishqyrtimin dhe harmonizimin e vendimit sipas rekomandimeve të MAPL-së Sh.01 Nr.13600,**
3. **Të ndryshme.**

**Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës,** jemi në mbledhjen e shtatë kam edhe një propozim për rend dite, fjala është për raportin tre mujor financiar, kush është që kjo pikë të hyjë në rend dite?
**Për u deklaruan të gjithë.**

Kemi një pikë tjetër për rend dite, fjala është Propozim-vendim për shpalljen në interes të përgjithshëm, janë tri prona të cilat propozohen që të shpallen me interes të përgjithshëm.
**Kush është që të hyjë në rend dite?**
**Për u deklaruan të gjithë.**

**Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës-** miratojmë në tërësi rendin e ditës. Kush është për miratimin e rendit të ditës?
**Për u deklaruan të gjithë.**

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e VI-të e Komitetit për Politikë dhe Financa,**

**Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës-** jemi në pikën e parë të rendit të ditës, a keni diskutime për këtë pikë, nëse jo e hedhim në votim,
**Kush është për miratimin e pikës së parë?**
**Për u deklaruan të gjithë.**

2. **Kërkesë për rishqyrtimin dhe harmonizimin e vendimit sipas rekomandimeve të MAPL-së Sh.01 Nr.13600,**

**Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës,** kjo ka të bëjë me vendosjen e trafos që është në zonën e Poliqkës, ministria ka kërkuar një dokument tjetër pëlqimin nga KEDS-i edhe pse e kemi dërguar me kohë, por nuk është pranuar nga ministria, kush është që kjo të vazhdojë për kuvend?
**Për u deklaruan të gjithë.**

3. **Raporti financiar tre mujor Prill-Qershor**

**Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës-**a keni diskutime për këtë pikë, nëse jo e hedhim në votim,
**Kush është për pikën e tretë?**
**Për u deklaruan të gjithë.**

4. **Propozim-Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm**

**Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës,** në këtë pikë kemi shpalljen e tri parcelave në interes të përgjithshëm, nëse nuk keni diskutime për këtë pikë e kalojmë në kuvend,
**Kush është për miratimin e pikës së katërt?**
**Për ..................5**
**Kundër............0**
**Abstenim...........1**

5. **Të Ndryshme**

**Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës-** a keni diskutime tek pika në të ndryshme, nëse jo e shpallim të mbyllur takimin e sotëm.

**Takimi mbyllet ora: 14:20**

**Procesmbajtës**
**Sabile Arifi**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kamenicës**
**Liridon Kastrati**

**Z A P I S N I K**

**Sa VII-e sednice Komitata za Politiku i Finansije održanoj dana: 18.07.2025**

Sednica bila predviđena se održati 17.07.2025, ali odložena za 18.07.2025 i počela u 14:10 časova. Na sednici osim članova prisutni i Direktorka za Finansije i Budžet, stručna skupštinska služba, prevodilac, kancelarija informisanja i predstavnik OEBS-a. Sednicu otvorio i njome predsedavao Predsedavajući Komiteta za Politiku i Finansije Liridon Kastrati koji za sednicu predložio sledeći:

**Devni red**

1. **Razmatranje i usvajanje zapisnika sa VI-e sednice Komiteta za Politiku i Finansije,**
2. **Zahtev za ponovno razmatranje i usaglašavanje odluke prema preporukama MALS-a, Š 01 Br.13600,**
3. **Razno.**

**Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Kamenica,** nalazimo se na sedmoj sednici, imam još jedan predlog za dnevni red, radi se tromesečnog fiansijskog izveštaja, ko je da se ova tačka uvrsti u dnevni red?
**Za su se svi izjasnili.**

Imamo još jednu tačku za dnevni red, reč je o Predlog odluke za proglašenje od opšteg interesa, tu su tri imovine koje se predlažu od opšteg interesa.
**Ko je da se i ova tačka stavi u dnevni red?**
**Za su se svi izjasnili.**

**Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Kamenica** – usvajamo u celosti dnevni red.
Ko je za usvajanje dnevnog reda?
**Za su se svi izjasnili.**

1. **Razmatranje i usvajanje zapisnika sa VI-e sednice Komiteta za Politiku i Finansije,**

**Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Kamenica** – nalazimo se kod prve tačke dnevnog reda, ima li diskusije po ovoj tački, ako nema stavljam na glasanje,
**Ko je za usvajanje prve tačke?**

**Za su se svi izjasnili.**

2. **Zahtev za ponovno razmatranje i usaglašavanje odluke prema preporukama MALS-a, Š 01 Br.13600,**

**Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Kamenica,** ovo se odnosi na postavljanje električnog transformatora, nalazi se u zoni Polićka. Ministarstvo tražilo drugi dokument, saglasnost KEDS-a, mada smo im na vreme slali, ali nije prihvaćeno od ministarstvo, ovo da se produži za u skupštinu?
**Za su se svi izjasnili.**

3. **Tromesečni finansijski izveštaj April-Juni**

**Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Kamenica** –ima li diskusije po ovoj tački, ako nema stavljam na glasanje,
**Ko je za usvajanje treće tačke?**
**Za su se svi izjasnili.**

4. **Predlog Odluke za proglašenje od opšteg interesa**

**Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Kamenica,** po ovoj tački imamo proglašenje tri parcela od opšteg interesa, ako nema diskusije po ovoj tački stavljamo da se prosledi za skupštinu.
**Ko je za usvajanje četvrte tačke?**
**Za ..................5**
**Protiv............0**
**Uzdržano.......1**

5. **Razno**

**Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Kamenica** – ima li diskusije kod tačke razno, ako nema današnju sednicom proglašavam zatvorenom.

**Sednica završena u: 14:20 časova**

**Prevod: Rexhep Ibrahimi**

**Zapisničar**
______________________
**Sabile Arifi**

**Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica**
______________________
**Liridon Kastrati**

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
Nj. org. 02 Nr. Prot. 5376-2/25
Nr. i Faqeve -02- Data 06.08.25
PRISHTINË / A

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*
*Ministarstvo Źivotne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës<br>Liridon Kastrati, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kamenicës | |
| Kopje: | Elbert Krasniqi, Ministër në Detyrë në MAPL<br><br>Jeton Qela Sekretar i Përgjithshëm në MAPL<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL | |
| Përmes: | Liburn Aliu, Ministër në Detyrë në MMPHI<br><br>Izedin Bytyqi, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPHI | |
| Nga: | Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor | Nr. 135/25<br>Datë: 16.07.2025 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br>1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Shendrita Latifi – Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit dhe Mbështetjes Ligjore | |
| Lënda: | Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal | |
| Lloji i aktit: | Vendimi 01 Nr. 17378 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit shumë funksional në shërbim të komunitetit lokal në fshatin Muçivërc, miratuar nga Kuvendi Komunal i Kamenicës, datë 30.06.2025 | |

I nderuar kryetar Rahimaj,
I nderuar kryesues Kastrati

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 11.07.2025 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Vendimin 01 Nr. 17378 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit shumë funksional në shërbim të komunitetit lokal në fshatin Muçivërc, miratuar nga Kuvendi Komunal i Kamenicës, datë 30.06.2025.

MMPHI pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave kërkon nga Kuvendi Komunal i Kamenicës:

**RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT**

Vendimi 01 Nr. 17378 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit shumë funksional në shërbim të komunitetit lokal në fshatin Muçivërc, miratuar nga Kuvendi Komunal i Kamenicës, datë 30.06.2025.

**ARSYETIMI**

MMPHI pas shqyrtimit të vendimit të lartcekur konstatoi se:

Në preambulë, ky vendim bazohet në Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, për të cilin ligj nuk kemi kompetencë.

Sa i përket destinimit të parcelës, sipas dokumentacionit të bashkëngjitur në Letër Informatë datë 07.07.2025 nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, parcela në fjalë, bazuar në dokumentin e planifikimit hapësinor në fuqi, është paraparë për Hapësirë Shkollore. Gjithashtu, Plani Zhvillimor Komunal i miratuar këtë vit nga Komuna, e përcakton po ashtu këtë shfrytëzim.

Inkurajojmë Komunën e Kamenicës që të fillojë sa më parë procesin e hartimit të Hartës Zhvillimore Komunale (HZK), sipas parashikimeve ligjore në fuqi, në mënyrë që shfrytëzimet e tilla të përfshihen dhe të jenë të qarta në dokumentet përkatëse.

Njëkohësisht, bazuar në Rregulloren e Qeverisë së Republikës Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, dhe Shtojcën: Lista e akteve të komunës që nuk i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ky vendim mund të përfshihet në kuadër të kësaj liste.

Nga ajo që u tha më lartë, të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e Ligjit Nr. 08/ L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave.